

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Elementet e njohurive të
Auditimit të Brendshëm
Internal Audit Knowledge
Elements**

B1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 19/06/2022

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Në cilin nga shtetet e mëposhtme pronarët dhe punëtorët janë anëtarë të bordeve?
 - A. Kanada.
 - B. Shtetet e Bashkuara.
 - C. Francë.**
 - D. Mbretërinë e Bashkuar.
2. Bindja ndaj Ligjit për praktikën e jashtme korruptive, është pjesë e cilës prej përgjegjësisë sociale të mëposhtme të korporatave?
 - A. Përgjegjësisë etike.
 - B. Përgjegjësisë ekonomike.
 - C. Përgjegjësisë ligjore.**
 - D. Përgjegjësisë filantropike.
3. Shmangia e praktikave të diskutueshme; reagimi në frymën dhe fjalën e ligjit; bërja e asaj që është vetëm, e drejtë, e ndershme është pjesë e cilës prej përgjegjësisë sociale të korporatave?
 - A. Përgjegjësisë etike.**
 - B. Përgjegjësisë ekonomike.
 - C. Përgjegjësisë ligjore.
 - D. Përgjegjësisë filantropike.
4. Bazuar në kornizën e qeverisjes së korporatave (1) detyra e kujdesit, (2) 'veprimet për vetë' dhe (3) mundësitë e korporatës janë detyra në mirëbesim që janë përgjegjësi e:
 - A. Bordit të drejtorëve**
 - B. Krye-shefit ekzekutiv
 - C. Aksionarëve
 - D. Auditorëve të brendshëm
5. Cilat nga pohimet e mëposhtme janë të sakta lidhur me përgjegjësitë kryesore të komitetit të auditimit?
 - A. Të sigurojë që pasqyrat financiare të publikuara nuk janë çorientuese.
 - B. Të sigurojë që kontrollet e brendshme janë adekuate.
 - C. Të përcjellë akuzat për parregullsitë materiale, financiare, etike, dhe ligjore.
 - D. Të gjitha më sipër.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Mrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

6. Nga pohimet e mëposhtme, cili pohim përshkruan rolet dhe përgjegjësit e Komisionit për qeverisje?
- A. Maksimizon efektivitetin e bordit përmes rishikimit dhe vlerësimit vjetor të strukturës, madhësisë, përbërjes, zhvillimit dhe përzgjedhjes së anëtarëve të bordit dhe të komisioneve të tij.**
 - B. Siguron kontroll mbi përzgjedhjen e kandidatëve për bordin e drejtorëve dhe drejtuesve kryesor ekzekutiv.
 - C. Përqendrohet në marrëveshjet për kompensimin e anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe drejtuesve kryesor ekzekutiv.
 - D. Mbikëqyrë programet e përfitimit të punonjësve dhe siguron që ato janë në përputhje me objektivat e organizatës.
7. Rishikimi sistematik dhe i strukturuar i identifikimit të çështjeve dhe problemeve në të kuptuarit dhe zbatimin e strategjisë së miratuar të korporatës në funksione dhe aktivitetet të ndryshme të biznesit si dhe dhënien e rekomandimeve për të zgjidhur çështjet dhe problemet e tilla është lloji i auditimit:
- A. Të palëve të interesuara
 - B. Të qeverisjes
 - C. Strategjik**
 - D. Të përkushtimit të duhur
8. Një mjet që në përgjithësi NUK përdoret për të menaxhuar rrezikun subjektiv është:
- A. Marrja e më shumë informatave
 - B. Diskutim ne grup
 - C. Ulje e nivelit të ashpërsisë**
 - D. Identifikimi dhe analizimi sistematik i metodave të përshtatshme për trajtimin e rreziqeve
9. Cila nga opsionet në vijim paraqet më së miri analizën e ndikimit të biznesit si një mjet për menaxhimin e rrezikut?
- A. Kjo analizë përfshin caktimin e vlerësimeve të probabilitetit ndaj rezultateve alternative dhe përmbledhjen e produkteve të rezultateve të ndryshme.
 - B. Kjo analizë kryhet pasi të identifikohen të gjitha kontrollet e mundshme dhe të vlerësohet fizibiliteti dhe efektiviteti i tyre për secilin kontroll të propozuar për të përcaktuar se cilat kontrolle kërkohen dhe të përshtatshme për rrethanat e tyre.
 - C. Kjo analizë mund të zbatohet për çdo funksion të biznesit, operacion, ose mision dhe rezultatet pastaj integrohen në strategjitë e biznesit, planet, politikat dhe procedurat.**
 - D. Kjo analizë tregon se sa do të ndodhë ndryshim në rezultate si përgjigje ndaj një ndryshimi të dhënë në inpute.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

10. Menaxhimi i rrezikut ka të bëjë kryesisht me:
- A. Rreziqet dinamike
 - B. Rreziqet e pastra**
 - C. Rreziqet spekulative
 - D. Rreziqet themelore
11. Shmangia e rrezikut duhet të përdoret në ato raste në të cilat:
- A. Ashpërsia e humbjes është e lartë.
 - B. Ashpërsia dhe shpëstësia e humbjes janë të larta.**
 - C. Frekuenca e humbjes është e lartë.
 - D. Frekuenca ose ashpërsia nuk mund të përcaktohet.
12. Lidhur me sigurinë e sistemit të informacionit, qëllimi i analizës së rrezikut është që të arrihet një:
- A. Balancë teknike midis ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse.
 - B. Balancë operacionale në mes ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse.
 - C. Balancë ekonomike në mes ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse.**
 - D. Balancë ligjore midis ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse.
13. Rreziku i kapitalit njerëzor është shumë i rëndësishëm dhe një ndër më të rrezikshmit që duhet të shikohet. Ekzistojnë katërmbëdhjetë (14) praktika më të mira për të reduktuar rreziqet e njerëzve. Cilat nga praktikat e mëposhtme përdoren për menaxhimin e rrezikut të kapitalit njerëzor?
- A. Caktimi i zyrtarit kryesor i burimeve njerëzore.
 - B. Balancimi në mes të marrjes së tepër shumë të dhënave dhe tepër pak të dhënave, kur kërkojmë referenca për punonjësit e ardhshëm.
 - C. Sigurimi i pagesës së drejtë dhe të barabartë të pagave dhe mëditjeve.
 - D. Të gjitha më sipër.**
14. Performanca është aftësia e organizatës për të arritur qëllimet e veta duke përdorur burimet në mënyrë efikase dhe efektive. Ekzistojnë 4 komponentë të matjes së produktivitetit. Cila nga opsionet e mëposhtme NUK është komponent i matjes së produktivitetit?
- A. Inputet
 - B. Outputet e përkohshme
 - C. Proceset
 - D. Përfshirja e të punësuarve.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

15. Sistemi i kartelës së rezultateve të balancuara është një sistem gjithëpërfshirës i kontrollit të menaxhimit i cili balancon masat tradicionale financiare me masat jo financiare. Kaplan dhe Norton e ndajnë strategjinë e kartelës së rezultateve të balancuar në katër perspektiva apo kategori. Perspektiva e cila shikon në drejtim nga brenda jashtë paraqet cilin lloj të perspektivës?
- A. Perspektivën financiare
 - B. Perspektivën e proceseve të brendshme**
 - C. Perspektivën e konsumatorëve
 - D. Perspektivën e inovacionit
16. Koha mes vendosjes së një porosie dhe asaj kur pranohet nga klienti njihet si:
- A. Koha e arritjes
 - B. Koha e ciklit të porosisë**
 - C. Koha e transportit
 - D. Koha e porositjes
17. Kostoja e mbajtjes së inventarit është e barabartë:
- A. Inventari mesatar në Euro x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit
 - B. Inventari mesatar në njësi x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit**
 - C. Saldo përfundimtare e inventarit në Euro x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit
 - D. Saldo përfundimtare e inventarit në njësi x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit.
18. Një sistem i planifikimit të kërkesave për materiale (MRP) do të ishte më i vështirë të aplikohet për një prodhues i cili:
- A. Përdor relativisht pak materiale direkte
 - B. Ka kohë të gjatë të strukturimit të pajisjeve prodhuese
 - C. Është në një industri shumë të paqëndrueshme**
 - D. Përballon kosto të larta joproductive
19. Cili nga ISO standardet në vijim NUK është i përshtatshëm për qëllime të certifikimit?
- A. ISO 9001 – Menaxhimi i Cilësisë.
 - B. ISO 31000 – Menaxhimi i rrezikut.**
 - C. ISO 14001 – Menaxhimi i Mjedisit.
 - D. ISO 22000 – Menaxhimi i Sigurisë Ushqimore
20. Cila nga opsionet në vijim NUK është përgjegjësi e standardit ISO 9001 në sistemin e menaxhimit të cilësisë?
- A. Specifikimi i kërkesave për mallrat ose shërbimet që blerësit kërkojnë për të blerë.**
 - B. Sigurimi i vizatimeve dhe skemave të reklamave për projektuesit.
 - C. Dërgimi i katalogëve të furnizuesve tek klientët.
 - D. Referimi i klientëve ndaj standardeve kombëtare ose ndërkombëtare të produktit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

21. Standardi ISO 26000 fokusohet në përgjegjësinë sociale. Cila nga sa vijon nuk është objekti i standardit ISO 26000?
- A. Të drejtat e njeriut.
 - B. Menaxhimi i riskut.**
 - C. Çështjet e konsumatorit.
 - D. Praktikrat e punës.
22. Cili nga pohimet e mëposhtme NUK është e saktë në lidhje me përfitimet e angazhimit të burimeve të jashtme (outsourcing) të një procesi ose funksioni biznesi?
- A. Përmirëson performancën e sistemeve dhe punonjësve.
 - B. Redukton kostot operative dhe investimet kapitale.
 - C. Redukton kontrollin mbi shitësit e jashtëm.**
 - D. Parandalon punësimin e punonjësve shtesë për të përmbushur nevojat e përkohshme.
23. Cila nga hallkat në zinxhirët e komunikimit kërkon që mesazhet e transmetuara të jenë të njëjta në mes të dërguesit dhe marrësit.?
- A. Kodimi.
 - B. Dëshifrimi/ Dekodimi.**
 - C. Prapa veprimi - Feedback.
 - D. Perceptimi.
24. Ekzistojnë shumë pengesa në mes të gjithë njerëzve, të cilat e bëjnë komunikimin të vështirë. Nëse një auditor përdor zhargon në raportin e auditimit ka të ngjarë të has në cilën formë të pengesave të komunikimit?
- A. pengesat e procesit
 - B. pengesat fizike
 - C. pengesat semantike**
 - D. pengesat psikologjike ose sociale
25. Në analizën e situatës nga merren informacionet për mundësitë dhe kërcënimet për një kompani?
- A. Nga një analizë e mjedisit të brendshëm të organizatës.
 - B. Nga një studim nga departamentet e organizatës.
 - C. Nga një analizë e mjediseve të jashtme**
 - D. Nga një analizë e ankesave të punonjësve.
26. Të gjitha pohimet në vijim janë mënyra të mundshme për të zhvilluar një avantazh konkurrues në zinxhirin e vlerës, përveç njërit pohim:
- A. Nëpërmjet aktiviteteve që krijojnë vlerë për organizatën.**
 - B. Mënyrës se si aktivitetet e brendshme janë të lidhura me mjedisin e jashtëm.
 - C. Mënyrës se si kombinohen aktivitetet parësore dhe mbështetëse.
 - D. Në ndonjë nga aktivitetet parësore dhe mbështetëse.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Mrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

27. Barrierat për të hyrë në një industri lidhen me cilën nga forcat konkurruese të mëposhtme?
- A. Rivaliteti mes konkurrentëve.
 - B. Hyrje të reja të mundshëm.**
 - C. Presioni i produkteve zëvendësuese.
 - D. Fuqia negociuese e blerësve.
28. Cilat nga hapat e mëposhtëm janë hapat e veprimit me të cilët një organizatë synon të arrijë qëllimet e saj të përgjithshme?
- A. Qëllimet taktike.
 - B. Qëllimet operative.
 - C. Planet taktike.
 - D. Planet strategjike.**
29. Në modelin e matricës së Boston Consulting Group (BCG), pjesa e tregut përcaktohet si raporti i:
- A. Madhësisë së njësisë më të vogël të biznesit me madhësinë e konkurrentit të saj më të vogël.
 - B. Norma e rritjes së një firme ndaj normës së rritjes së industrisë së saj.
 - C. Fitimet e një firme ndaj fitimeve mesatare të industrisë së saj.
 - D. Madhësisë së njësisë së biznesit me madhësinë e konkurrentit të saj më të madh.**
30. Modeli GE përdor cilin nga sa vijon?
- I. Atraktivitetin e industrisë
 - II. Fuqitë konkurruese
 - III. Integrim vertikal
 - IV. Integrimi horizontal
- A. I dhe II**
 - B. Vetëm III
 - C. Vetëm IV
 - D. III dhe IV
31. Në kontekstin e menaxhimit total të cilësisë (TQM), analiza 20% e shkaqeve (disa pika jetike) përbëjnë 80% të pasojave (problemeve) paraqitet me:
- A. Diagram Pareto**
 - B. Grafikët e rrjedhjes
 - C. Diagramët 'shkaku dhe pasoja'
 - D. Grafikët e kontrollit

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

32. Në kontekstin e strategjisë ose programit të menaxhimit total të cilësisë, mënyra më e mirë për të parë Kaizen është se ai është një:
- A. Program.
 - B. Procedurë.
 - C. Destinacion.
 - D. Udhëtim.**
33. Matja e kostos së cilësisë (COQ) identifikon fushat për përmirësimin e procesit. Fokusi i kësaj matjeje është tek shprehja e cilësisë në aspektin e gjuhës sasiore dhe financiare. Komponentët e kostos së cilësisë janë të gjitha në vijim përveç:
- A. kostot e parandalimit
 - B. kostot e vlerësimit
 - C. kostot e dështimit
 - D. kostos së ri - bërjes së punës**
34. Pasi përjetoi ulje në nivelet e performancës, një kompani zbatoi disa ndryshime në menaxhimin dhe metodat e prodhimit për të përmirësuar cilësinë dhe produktivitetin e produktit. Si ndryshimi i parë i tij, menaxhmenti organizoi qarqet e cilësisë. Këto grupe punonjësish, duke përfshirë mbikëqyrësit, takoheshin çdo javë për të identifikuar dhe diskutuar problemet, për të hetuar shkaqet dhe për të rekomanduar dhe zbatuar veprime korigjuese.
- Të gjitha produktet e kompanisë përfshijnë teknologji të lartë, lëndë të para të specializuara dhe fuqi punëtore të kualifikuara. Në të kaluarën, prodhimi organizohej rreth punonjësve shumë të trajnuar dhe të specializuar. Në përpjekje për të përmirësuar më tej prodhimin, kompania u bë më pak e specializuar duke e zgjeruar prodhimin horizontalisht. Ky ndryshim nënkuptonte se si shumëllojshmëria ashtu edhe numri i detyrave të kryera nga një individ u rrit. Si rezultat, numri mesatar i produkteve për çdo punonjës për të prodhuar u reduktua nga shtatë në katër. Kur bënë këto ndryshime, menaxhmenti u tha punonjësve se nëse kompania do të qëndronte në biznes, produktiviteti dhe cilësia e produktit kishin nevojë për përmirësim të madh. Menaxhmenti u përpoq të bindë punonjësit se duke mësuar aftësi shtesë dhe duke punuar brenda qarqeve të cilësisë, do të rriteshin si prodhimi ashtu edhe cilësia. Ata siguruan punonjësit se trajnimi shtesë dhe puna e palodhur do t'u mundësonte atyre të zhvillojnë aftësi të reja dhe të arrijnë sukses në qarqet e cilësisë. Shpjegimet dhe argumentet e menaxhmentit janë aplikimi i cilës dukuri në vijim?
- A. Përforcimit të sjelljes pozitive.
 - B. Duke i bërë të ditur punonjësit se çfarë pritet prej tyre.**
 - C. Përdorimit të nevojave të identifikuar të punonjësve për të motivuar punonjësit.
 - D. Supozimit se punonjësit do të punojnë aq shumë sa duhet në mënyrë që të trajtohen në mënyrë të drejtë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

35. Një nga pengesat në grafikun tradicionale Gantt të përdorur në menaxhimin e projekteve është se NUK paraqet grafikisht cilën nga sa vijon?
- A. Rendin e aktiviteteve
 - B. Afatin kohor të aktiviteteve
 - C. Marrëdhëniet e veprimtarive**
 - D. Strukturën e veprimtarive
36. Cila nga politikat në vijim përcakton mbulimin mbi të gjitha subjektet dhe objektet në kontrollin e tij, për të siguruar që çdo përdorues merr vetëm ato të dhëna për të cilat ka qasje të autorizuar bazuar në klasifikimin e të dhënave dhe në lejen e përdoruesit, dhe autorizimin formal në qasje.
- A. Politika e kontrollit të detyrueshëm të qasjes (MAC)**
 - B. Politika e kontrollit të qasjes bazuar në rol (RBAC)
 - C. Politika e kontrollit të qasjes e bazuar në identitet (IBAC)
 - D. Politika e kontrollit të qasjes e bazuar në attribute (ABAC)
37. Cila nga opsionet në vijim paraqet tre politikat kryesore të qasjes?
- A. Politika e kontrollit diskrecional të qasjes (DAC); Politika e kontrollit të detyrueshëm të qasjes (MAC), dhe Politika e kontrollit të qasjes bazuar në rol (RBAC)**
 - B. Politika e kontrollit diskrecional të qasjes (DAC); Politika e kontrollit të qasjes e bazuar në identitet (IBAC) dhe Politika e kontrollit të qasjes e bazuar në attribute (ABAC)
 - C. Politika e kontrollit të detyrueshëm të qasjes (MAC); Politika e kontrollit jo diskrecional të qasjes (NDAC) dhe Politika e kontrollit të qasjes e bazuar në rregull (RuBAC)
 - D. Politika e kontrollit të qasjes bazuar në rol (RBAC); Politika e kontrollit të qasjes e bazuar në identitet (IBAC) dhe Politika e kontrollit të qasjes e bazuar në attribute (ABAC)
38. Cilat politika të kontrollit të qasjes nuk janë të përshtatshme për sektorin privat dhe publik në përpunimin e të dhënave të paklasifikuara por të ndjeshme.
- I. Politika e kontrollit diskrecional të qasjes (DAC)
 - II. Politika e kontrollit të detyrueshëm të qasjes (MAC)
 - III. Politika e kontrollit të qasjes e bazuar në identitet (IBAC)
 - IV. Politika e kontrollit të qasjes bazuar në rol (RBAC)
- A. I dhe II**
 - B. Vetëm I
 - C. II dhe III
 - D. III dhe IV

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

39. Renditja e saktë e veprimeve që ndodhin në një mekanizëm të kontrollit të qasjes është si vijon :
- A. Identifikimi → Autenticiteti → Autorizimi → Llogaridhënia**
 - B. Identifikimi → Autorizimi → Autenticiteti → Llogaridhënia
 - C. Autorizimi → Identifikimi → Autenticiteti → Llogaridhënia
 - D. Autorizimi → Autenticiteti → Identifikimi → Llogaridhënia
40. Në pasqyrën e rrjedhjes së parasë (metoda indirekte), shpenzimet e zhvlerësimit duhet të paraqiten si:
- A. Hyrje e parave.
 - B. Dalje e parave.
 - C. Një shtesë në të ardhurat neto në konvertimin e të ardhurave neto në neto rrjedhjen e parasë nga aktivitetet operative**
 - D. Një zbritje në të ardhurat neto në konvertimin e të ardhurave neto në neto rrjedhjen e parasë nga aktivitetet operative.
41. Kur një kompani ndryshon në metodën e vlerësimit të stoqeve në 'i fundit brenda, i pari jashtë' (LIFO) nuk ka ri-deklarim të të ardhurave të vitit të kaluar sepse:
- A. Ri-paraqitja do të ishte jopraktik.**
 - B. Ri-paraqitja do të reduktonte dobinë e pasqyrave të periudhës së mëparshme.
 - C. Ri-paraqitja nuk do të ndryshonte rezultatin e raportuar.
 - D. Ri-paraqitja do të reduktonte të ardhurat e vitit të kaluar.
42. Cili nga gabimet e mëposhtme nuk korrigjohet vetë gjatë dy periudhave kontabël (një gabim që nuk është kundër balancues nga vetvetja) ?
- A. Mos regjistrimi i pagave të përlllogaritura.
 - B. Mos regjistrimi i amortizimit.**
 - C. Mbivlerësimi i blerjeve të stoqeve.
 - D. Mos regjistrimi i shpenzimeve të parapaguara.
43. Një kompani që zotëron një ekip të ri basketbolli shet bileta sezoni për lojërat e ekipit të saj. Sezoni zgjat nga nëntori deri në prill, me dhjetë ndeshje të luajtura çdo muaj. Në vitin 2021, kompania mblodhi 3,000,000 euro nga shitja e biletave sezonale për sezonin 2021-2022. Fundi i vitit fiskal të saj është 31 dhjetor. Bazuar në këtë informacion, kompania duhet të:
- A. Raportoje një detyrim për të hyrat e pa-fituara prej 2,000,000€ në bilancin e tij të 31 dhjetorit 2021.**
 - B. Raportoje një detyrim për të hyrat e pa-fituara prej 3,000,000€ në bilancin e tij të 31 dhjetorit 2021.
 - C. Raportoje të ardhurat prej 3,000,000€ në pasqyrën e të ardhurave të vitit 2021.
 - D. Raportoje të ardhurat prej 1,000,000€ në pasqyrën e të ardhurave 2023.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

44. Trajtimi kontabël për një rregullim të periudhës së mëparshme korrigjon pasqyrën e të ardhurave të periudhës me të cilën lidhet ngjarja. Fitimet e paspërndara në hapje rregullohen për efektin pas tatimit të rregullimit të periudhës së mëparshme. Një rregullim i periudhës së mëparshme ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave të një periudhe të mëparshme sepse:
- A. Një rregullim i periudhës së mëparshme tregon se ka pasur një gabim në pasqyrat e mëparshme financiare; prandaj, pasqyrat e mëparshme financiare janë korrigjuar.
 - B. Pasqyra e të ardhurave të periudhës aktuale portretizon vetëm fitimet e rregullta, të përsëritura të biznesit, bazuar në operacionet normale. Një rregullim i periudhës së mëparshme nuk është një ngjarje e rregullt dhe e përsëritur.
 - C. Pasqyra e të ardhurave të periudhës aktuale portretizon ngjarje ose vlerësime që lindin vetëm në periudhën aktuale. Një rregullim i periudhës së mëparshme është një korrigjim për një ngjarje ose vlerësim që ka ekzistuar në një periudhë të mëparshme.**
 - D. Pasqyra e të ardhurave të periudhës aktuale pasqyron aftësinë afatgjatë të prodhimit të të ardhurave të ndërmarrjes. Një rregullim i periudhës së mëparshme nuk është një tregues i aftësisë së prodhimit të të ardhurave me rreze afatgjatë.
45. Për shkak të një defekti të zbuluar në rripat e sigurimit në dhjetor 2021, një prodhues automobilash beson se ka të ngjarë që do t'i kërkohej të tërheqë nga tregu produktet e tij. Vendimi përfundimtar për tërheqjen pritet të merret në mars 2022 dhe vlerësohet t'i kushtojë prodhuesit të automobilave 2,500,000 Euro. Si duhet të raportohet ky informacion në pasqyrat financiare të 31 dhjetorit 2021?
- A. Si një humbje prej 2,500,000€ dhe një detyrim prej 2,500,000€.**
 - B. Si një rregullim i periudhës së mëparshme prej 2,500,000€.
 - C. Si përvetësim i fitimeve të paspërndara prej 2,500,000€.
 - D. Nuk duhet të bëhet e ditur sepse ende nuk ka ndodhur.
46. Dështimi për të regjistruar një shpenzim të përlllogaritur në fund të vitit do të rezultojë në cilin nga gabimet e mëposhtëm të mbivlerësimit në pasqyrat financiare të përgatitura në atë datë?
- A. Të ardhurave neto
 - B. Kapitalit qarkullues
 - C. Parave të gatshme
 - D. Të ardhurave neto dhe kapitalit qarkullues**
47. Një kompani ofron shërbime monitorimi për sistemet e sigurisë së shtëpive. Ai mbledh paraprakisht tarifat tremujore të monitorimit. Gjatë vitit 2022, kompania mbledhi 400,000 euro për tarifat që i përkasin vitit 2022. Në pasqyrat financiare, këto fatura paradhënie duhet të klasifikohen si:
- A. Të ardhurat në pasqyrën e të ardhurave.
 - B. Të ardhura të pa-fituara në pasqyrën e pozicionit financiar.**
 - C. Të ardhura të përlllogaritura në pasqyrën e pozicionit financiar.
 - D. Detyrime të përlllogaritura në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

48. Në cilën nga kulturat e mëposhtme komunikimi përdoret kryesisht për të shkëmbyer fakte dhe informacione?
- A. Kultura me kontekst të lartë.
 - B. Kultura me kontekst të ulët.**
 - C. Kulturë me kontekst të mesëm.
 - D. Kultura pa kontekst.
49. Cila nga sa vijon është jetike për komunikim në kulturën me kontekst të lartë?
- A. Të qenurit në kohë.
 - B. Shenjat jo-verbale dhe situative.**
 - C. Të qenit i sjellshëm.
 - D. Kontaktet e shkruara.
50. Shkalla e papunësisë në një vend u rrit nga 4% në 6%. Kostoja ekonomike e kësaj rritjeje të papunësisë mund të përshkruhet si shuma me të cilën:
- A. Bruto Produktin Kombëtar aktual (GNP) është më i ulët se GNP-ja potenciale.**
 - B. Shpenzimet agregate janë më të ulëta se niveli i punësimit të plotë të produktit kombëtar neto.
 - C. Shpenzimet agregate tejkalojnë nivelin e punësimit të plotë të produktit kombëtar neto.
 - D. Importet e mallrave tejkalojnë eksportet.